    - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të Shërbimeve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 7. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 8. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit

Formulari 12- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër  
(Pas procesit të ankimit)

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
  - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  - 2. Njoftimin e Kontratës;
  - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
  - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  - 8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

---

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Shtojca 2.***(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE****Data:** \_\_\_\_\_**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):**  
\_\_\_\_\_**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>		
<b>Artikulli</b>	<b>Përshkrimi i shërbimit</b>	<b>Sasia/njesia</b>	<b>çmimi për njësi</b>	<b>Çmimi total për shërbim (3 x 4X)</b>	<b>Afati</b>	
<b>1.</b>	Mirembajtje software CRM dhe billing	12 muaj			12 muaj	12 muaj
<b>2.</b>	Shërbime Suporti Onsite dhe Remote	12 muaj			12 muaj	
<b>3.</b>	Mirembajtje Hardware	12 muaj			12 muaj	
	<b>Çmimi total (Mallrat)</b>				_____	
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>						
<b>TVSH (%)</b>						
<b>Çmimi total me TVSH:</b>						
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>						
<b>Nënshkrimi</b>						
<b>Vula</b>						
<b>Datë</b> _____						



### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)  
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]  
**FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS**

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

#### Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Përfaqësuesi i Ofertuesit

#### Nënshkrimi

#### Vula

---

**Shtojca 5.**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

**SHËNIM:** Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

---

**Shtojca 6**

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

**FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

**Shërbimi që kërkohet:** “Mirëmbajtje e sistemit CRM dhe Billing”

**Afatet e ekzekutimit:** 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontrates.

**Sasia e mallit/shërbimit që kërkohet:**

<b>Nr.</b>	<b>Pershkrimi</b>	<b>Sasia</b>	<b>Njesia</b>	<b>Cmimi</b>	<b>Totali</b>
1	Mirëmbajtje software CRM dhe Billing	12	Muaj		
2	Shërbime Suporti Onsite dhe Remote	12	Muaj		
3	Mirëmbajtje Hardware	12	Muaj		

---

## Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

### FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Specifikimet teknike të hartuara:

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

#### ANEKSI 1:

### 1. HYRJE

---

Sistemi Informatik Billing&CRM aktualisht përdoret nga katër kompanitë e OSHEE Group sh.a për realizimin e proceseve kryesore të punës së tyre. Me qëllim funksionimin e plotë të tij ky sistem ka nevojë për mirëmbajtje, dhe sipas nevojës, edhe për përmirësime të funksionaliteteve egzistuese të tij.

#### 1.1. Qëllimi

Qëllimi i këtij shërbimi është mirëmbajtja e sistemit Billing&CRM të OSHEE Group sha. dhe e të gjitha komponenteve hardware dhe software të tij. Disponueshmëria dhe vazhdimësia e funksionimit të sistemit me të gjithë komponentët e tij përbërës është shumë e rëndësishme për të patur një vazhdimësi të procesimit të informacionit dhe kryerjes së të gjitha detyrave në të katër kompanitë.

#### 1.2. Objektivat

Objekti kryesor i këtij shërbimi është mirëmbajtja e sistemit Billing dhe CRM në OSHEE Group sh.a për të siguruar vazhdimësinë e punës së këtij sistemi dhe e të gjithë sistemeve të integruar me këtë system, në mbi 99.9%, për të gjithë komponentët dhe shërbimet e ofruara nga ky sistem.

Ky shërbim ka si objekt edhe rregullimin dhe dokumentimin e çdo defekti, bug-u ose problematike të sistemit, pa kosto shtesë, gjatë gjithë periudhës së mirëmbajtjes.

---

## 2. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I SISTEMIT

---

### 2.1 Përshkrimi i përgjithshëm i sistemit

Sistemi Billing&CRM i OSHEE Group sh.a, është sistemi kryesor përmes të cilit katër kompanitë kryejnë proceset kryesore që lidhen me infrastrukturën dhe rrjetin energjitik, abonentët, faturimin periodik dhe arkëtimin e të ardhurave, printimin e faturave etj. Nga pikëpamja funksionale, ndërfaqja e sistemit është e organizuar në modulet e mëposhtme:

- a) Leximi i matësave
- b) Menaxhimi i workforcë-s
- c) Portali i Selfcare-t.
- d) Sistemi i Menaxhimit të Informacionit
- e) Ndërprerjet dhe Mbylljet.
- f) Shërbimi ndaj Klientit.
- g) Lidhje e re.
- h) Pagesat.
- i) Faturim.
- j) Konfigurime.
- k) Sistemi i Balancimit të Energjisë.

Përmes sistemit të Billing&CRM dhe integritit të tij me sisteme të tjera, OSHEE Group-it i mundësohet kryerja e proceseve thelbësore si, grumbullimi dhe administrimi i të dhënave të abonentëve dhe infrastrukturës së rrjetit energjitik, realizon kryerjen e proceseve të leximit/ faturimit/arkëtimin të abonentëve, gjenerimit dhe printimit të faturave të energjisë etj. Proçese si çelja e kontratës së një abonentit, hedhja dhe marrja e leximit mujor, përpunimi i leximit deri në gjenerimin e faturës, printimin e faturave, menaxhimin e matësave, krijimin e lidhjeve të reja dhe menaxhimin e të dhënave të abonentit, hedhja e pagesave, administrimi i debitorëve, krijimi i aktmarrëveshjeve, ndërprerjet, ankesë/kërkesat, workforca etj janë procese thelbësore për mbarëvajtjen e punës në katër kompanitë. Gjithashtu, nëpërmjet modulit të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit, kompanitë marrin raportime analitike dhe sintetike mbi situatën e proceseve. Sistemi është i integruar dhe shkëmben informacion me sisteme të tjera (p.sh sistemin e fiskalizimit, sistemin e kryerjes së leximeve, matjes online etj.). Ofruesit të shërbimit do t'i vihet në dispozicion dokumentacioni i strukturës së ndërtimit të sistemit që do të mirëmbahet.

---

## 3. REZULTATET QË DUHET TË ARRIHEN

---

Rezultatet konkrete që duhet të arrihen nga operatori ekonomik janë:

### Mirëmbajtja e sistemit dhe ofrimi i asistencës teknike:

- Mirëmbajtja dhe efienca e sistemit dhe sigurimin e punës normale në të gjithë funksionalitetet e tij siç është parashikuar në ndërtimin e sistemit;

- 
- Kryerja dhe kontrolli i procedurave të backup, restore etj dhe sigurimi i integritetit të tyre konform kërkesave dhe specifikimeve në ndërtimin e sistemit;
  - Realizimi i të gjitha funksionaliteve të punës së kompanisë ne raport me këtë sistem.
  - Mirëmbajtje e sistemit Billing & CRM, ku përfshihen rregullimi i bugeve, mirëmbajtje e aplikacionit, mirëmbajtje e databazës, mirëmbajtje e infrastrukturës, fine-tuning, zgjidhja e incidenteve specifike, monitorimi i performancës së aplikacionit etj.
  - Mirëmbajtje e sistemit Billing & CRM duhet të përfshijë gjithashtu mirëmbajtjen e softwarit të aplikacionit, databazës dhe infrastrukturës fizike për të realizuar funksionet e dëshiruara si në kontratën e ndërtimit të këtij sistemi. Kryerjen e proceseve të punës si kalimi i inputit për procesin e leximeve mujore, procesi i mbylljes së faturimit mujor, funksionalitet e workforcës, procesit të printimit, ngarkimi/ shkarkimi i dokumentave, raportime edhe të tjera procese operationale.
  - Çdo rregullim bug-u dhe errori duhet të dokumentohet siç është parashikuar në ndërtimin e këtij sistemi.
  - Realizimin e sigurisë së sistemit CRM&BILLING konform parametrave dhe standarteve të sigurisë së kompanisë OSHEE GROUP sh.a dhe atyre të parashikuara në ndërtimin e këtij sistemi.
  - Suporti duhet të jepet përmes e-mailit, telefonit dhe webit (e-mail and helpdesk tool) me qëllim që përdoruesit të realizojnë qëllimin e punës së tyre gjatë gjithë ditëve të javës 24/7, konform kërkesave të këtij dokumenti. Për çdo email, ose çështje, duke përshkruar problematikën, edhe zgjidhjen që iu dha problemit si edhe impaktin në sistem.
  - Kryerjen e ndryshimeve në sistem, për elementë që janë pjesë e funksionaliteve egzistuese të tij, sipas kërkesave të kompanisë.

---

## 4. SUPOZIMET DHE RISQET

---

### a. Supozimet

Faktori kyç i finalizimit me sukses të mirëmbajtjes është analizimi i kujdesshëm i proceseve egzistuese të punës dhe i të gjithë sistemit aktual në tërësi. Bashkëpunimi me stafin e departamentit të IT-së së OSHEE do të lehtësojë mbledhjen e informacioneve të duhura rreth sistemit egzistues.

### b. Risqet

- Mosanalizimi i mirë i situatës aktuale të punës.
- Keqinterpretimi i faktorëve që ndikojnë në performancën e sistemit.
- Vonesa në procesin e analizës dhe reagimit në rast mosfunksionimi të sistemit.
- Mosmarrja në konsideratë e volumit të punës bazuar në numrin e përdoruesve në sistem.

---

## 5. KËRKESAT FUNKSIONALE

---

### 5.1 Billing&CRM

Mirëmbajtja duhet të ofrojë mbështetje teknike për operationet e përditshme dhe ato periodike në të gjithë proceset e punës që realizon sistemi, ndryshimet në konfigurimin e sistemit, sistemit e të dhënave në raste

---

specifike, përditësimet e DB-së, gjenerimi i raporteve ose auditeve sipas nevojave të OSHEE, nevojat e integritetit me sisteme të tjera, support për backup/restore, suportin për aplikacion, database server, infrastrukture fizike etj. Në shërbimin e mirëmbajtjes do të përfshihen sa më poshtë:

a. Aktivitetet e mbuluara nga kjo mirëmbajtje përfshijnë rregullime të gabimeve të aplikacionit, mirëmbajtje të aplikacionit, databazës, hardware, pasjen e një performance të lartë të sistemit, trajtimin e incidenteve specifike dhe monitorimin e aplikacionit, databazës, infrastrukturës etj duke ruajtur integritetin dhe konsistencën e të dhënave.

b. Duhet të ofrohet mbështetje në rregullimin e gabimeve të softuerit dhe gabimeve të tjera të raportuara sipas rrethanave. Të gjitha incidentet dhe problemet e raportuara do të adresohen konform pikës 8 të këtij dokumenti.

c. Suporti duhet të ofrohet sipas kerkese se OSHEE Group sh.a për të ndihmuar përdoruesit fundorë në përdorimin e softuerit me qëllim përmbushjen e detyrave të tij gjatë gjithë ditëve të javës, sipas pikës 8 të këtij dokumenti.

d. Përgjigjet do të jepen për çdo email ose ticket të dërguar, duke përshkruar problemin që ka ndodhur, zgjidhjen e detajuar teknike që është dhënë dhe efektin në sistem.

e. Konsiderohen pjesë e mirëmbajtjes së sistemit, ndryshimet e kërkuara në funksionalitetet egzistuese të tij, të cilat do të trajtohen si ndryshime pa kosto shtesë.

f. Është përgjegjësi e OSHEE-së të sigurojë të drejtat e kërkuara të aksesit të sigurt në aplikacionet/ambjentet e instaluar të TI-së për suport në distancë/në vend, sipas nevojës.

## **6. LOGJISTIKA DHE KOHA**

---

### **6.1 Vendndodhja**

Baza operative e mirëmbajtjes është në Tiranë. Sistemi është i instaluar në serverat ekzistues të OSHEE Group sh.a, të cilët janë të instaluar në datacentre-in e OSHEE. Me tepër detaje janë dhënë në seksionin e kërkesave teknike.

### **6.2 Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave**

Data e fillimit të mirëmbajtjes do të jetë data e nënshkrimit të kontratës me operatorin ekonomik apo bashkimin e operatorëve fitues dhe periudha e mirëmbajtjes do të mbulojë 12 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

## **7. RAPORTIMI**

---

### **7.1 Kërkesat për Raportimin**

Kontraktuesi do të paraqesë raportet e mëposhtme në gjuhën shqipe në origjinal edhe 1 (një) kopje:

- **Raport Fillestar**, i cili duhet të dorëzohet 10 ditë nga fillimi i mirëmbajtjes së sistemit, ku të përshkruhen situata fillestare e sistemit, pritshmëritë etj.



- 
- **Raport mujor**, i cili duhet të dorëzohet çdo muaj nga operatori ekonomik bazuar në standardin e standardit të kërkuar nga OSHEE.
  - **Drafti i raportit përfundimtar** duhet të dorëzohet në fund të kontratës nga operatori ekonomik sipas standardit të kërkuar nga OSHEE.
  - **Raporti final** duhet të dorëzohet në fund të kontratës nga operatori ekonomik bazuar në standardin e kërkuar nga OSHEE, raport i cili duhet të përfshijë komentet e pranuar nga palët në draft raportin përfundimtar.

---

## 8. MIRËMBAJTJA

---

### 8.1 Kushtet e nivelit të shërbimit të mirëmbajtjes (SLA)

Shoqëria OSHEE GROUP sh.a kërkon plotësimin e kushteve për nivelin e shërbimit të mirëmbajtjes sipas pikave më poshtë:

- **Disponueshmëria e sistemit**

Sistemi duhet të jetë i disponueshëm, funksional dhe i aksesueshëm nga përdoruesit, pa pasur defekte 99.9 % të kohës, duke përfshirë të gjithë komponentët e sistemit. Përfundim bëjnë rastet kur disponueshmëria ndërpritet për shkak jo për faj të ofruesit të shërbimit.

Hapësirat kohore për mirëmbajtje të planifikuara në sistem nuk ndikojnë në matjen e disponueshmërisë.

- **Kufizimet e mundshme ndaj disponueshmërisë së shërbimit**

**Mirëmbajtja e planifikuar** e sistemit kryhet jashtë orarit zyrtar të punës. Ofruesi i shërbimit sigurohet që procesi i mirëmbajtjes të përfundojë para fillimit të orarit zyrtar të punës në ditën pasardhëse të punës.

**Mirëmbajtja e paplanifikuar** e sistemit kryhet pavarësisht orarit të punës Ofruesi i shërbimit përpiqet dhe vë në dispozicion të gjithë kapacitetet e nevojshme njerëzore dhe teknike që procesi i mirëmbajtjes të përfundojë sa më shpejt.

Backup-et periodike, përfshirë ato manuale dhe automatike, të sistemit dhe bazave të të dhënave kryhen jashtë orarit zyrtar të punës, që është nga e Hëna në të Shtunë orari 08.00-20.00. Ofruesi i shërbimit sigurohet që të gjithë sesionet e punës në sistem janë mbyllur dhe procesi i back-up të përfundojë para fillimit të orarit zyrtar të punës në ditën pasardhëse të punës.

- **Mirëmbajtja e sistemit**

Në rastet kur nevojitet kryerja e proceseve të mirëmbajtjes, restart i sistemit operativ ose restart i bazës së të dhënave dhe ky proces rrezikon disponueshmërinë e sistemit, ofruesi i shërbimit:

njofton me email dhe vetëm pasi merr konfirmim me email nga shoqëria vazhdon procesin e mirëmbajtjes;

per komponentet e sistemit te cilet jane te instaluar ne infrastrukturën e shoqërisë kryen procesin e mirëmbajtjes nën mbikëqyrjen fizike ose online nga punonjësit e IT të shoqërisë.

- **Matja e cilësisë së shërbimit**

Si kritere matës për cilësinë e shërbimit, OSHEE do të përdorë:

- Kohën e disponueshmërisë së sistemit (përqindje e ditë pune në vit);
- Performancën e sistemit (shpejtësia e transmetimit të të dhënave, koha e përgjigjes, koha e ekzekutimit të proceseve etj.). Sipas kontratës së ndërtimit të sistemit, disa kërkesa minimale janë:

- 
- Gjenerimi i faturave: 200 .000 fatura në jo më shumë se 6 (gjashtë) orë.
  - Kërkimi mesatar për detajet e kontratës së abonentit: më pak se 2 (dy) sekonda.
  - Kërkimi mesatar për detajet e historikut të pagesave të abonentit: më pak se 2 (dy) sekonda.
  - Kërkimi mesatar për gjetjen e kontratës së një abonenti në të gjithë bazën e abonentëve: më pak se 2 (dy) sekonda.
  - Numrin e rasteve të ndërprerjes së paplanifikuar të qasjes në sistem (përqindje e ditë pune në vit);
  - Kohëzgjatjen e egzekutimit të proceseve të rëndësishme periodike të katër kompanive të shoqërisë të specifikuar si në seksionin 3 të këtij dokumenti,

1. Kalimi i inputit për procesin e leximeve mujore\_brenda 24 orëve.
2. Procesi i mbylljes së faturimit mujor \_brenda 24 orëve.
3. Funksionalitet e workforcës\_çdo ditë.
4. Proçesit të printimit në vazhdimësi sipas kërkesave.
5. Raportime të përditësuara\_çdo ditë
6. Procese te tjera operationale\_ në vazhdimësi.
7. Ngarkimi/ shkarkimi i dokumentave\_ në kohë optimale.

-Kohën e përgjigjes për çdo problematikë të raportuar ose kërkesë për informacion.

- Anketimin e përdoruesëve (me vlerësim kënaqshëm ose jokënaqshëm).

Matja e cilësisë së shërbimit raportohet çdo muaj nga Shoqëria dhe përfshihet në vlerësimin e përgjithshëm të kontratës.

- **Kërkesat e shërbimit**

Problematikat e njoftuara nga Shoqëria ose të konstatuara nga ofruesi i shërbimit duhet të gjejnë zgjidhje brenda 2 orëve nga koha e njoftimit, ne rastet kur problematika rrezikon funksionimin e sistemit dhe aktivitetin e kompanive. Në rastet kur nevojitet më tepër kohë, afati i parashikuar për zgjidhjen duhet të njoftohet, i shoqëruar me arsyetim. Në rastin kur afati parashikohet më shumë se 2 orë ai miratohet nga ndjekësit e kontratës.

Shërbimi i mbështetjes nga ofruesi i shërbimit do të kryhet me qasje në distancë (remoteaccess) ose me paraqitje në ambientet e Shoqërisë. Shoqëria rezervon të drejtën e mbikëqyrjes fizike ose online, në kohë reale, të të gjithë procesit të dhënies së shërbimit të mbështetjes. Gjithashtu, Shoqëria mundëson për punonjësit përgjegjës të ofruesit të shërbimit vetëm të drejta qasjeje të përkohshme në sistemet IT që preken shërbimi i mbështetjes.

- **Menaxhimi i vazhdueshmërisë së shërbimit**

Në rastet te incidenteve hardware/software të sistemit ne site primar, ofruesi i shërbimit duhet ta kalojë shërbimin në disaster recovery site, dhe autoriteti kontraktor nuk duhet te ketë shkeputje të shërbimit. Ne rast kur kërkohet rikuperim i plotë i të dhënave, ofruesi i shërbimit përpiqet dhe vë në dispozicion të gjithë kapacitetet e nevojshme njerëzore dhe teknike që procesi i rikuperimit të përfundojë para fillimit të orarit zyrtar të punës në ditën pasardhëse të punës. Në rastet kur kërkohet rikuperim i plotë i të dhënave të sistemit, ofruesi i shërbimit vë në dispozicion backupet e datës paraardhëse (duke referuar datën e njoftimit të incidentit):

- Në nivel sistemi operativ për serverët e virtualizuar;
- Në nivel backupi të bazës së të dhënave për serverët fizikë.

Ofruesi i shërbimit harton planin e rikuperimit të të dhënave duke përfshirë dhe detyrat që i ngarkohen punonjësve IT të Shoqërisë. Plani i rikuperimit të të dhënave dorëzohet brenda 2 (dy) javëve nga data e nënshkrimit të kontratës.

- **Trajtimi i informacionit konfidencial**

Në asnjë rast, ofruesi i shërbimit nuk duhet të keqpërdorë ose të shpërndajë të dhënat konfidenciale të Shoqërisë, të cilat mund t'i ketë përfutur për shkak të nevojës së ndërhyrjes në sistem, ose të aksesit të mundshëm që ka ndaj të dhënave.

- **Njoftimi i problematikave dhe i vlerësimeve periodike**

Njoftimi për shfaqjen dhe zgjidhjen e problematikave do të kryhet:

me email, në/nga adresa të përcaktuara me marrëveshje për të dyja palët; ose

në një portal për ndjekjen e problematikave.

Portali për ndjekjen e problematikave (supportticketsystem) do të vihet në dispozicion dhe mirëmbahet nga ofruesi i shërbimit, duke mundësuar qasjen për punonjësit përgjegjës të Shoqërisë.

- **Punonjësit përgjegjës**

Punonjësit e ngarkuar me njoftimin e problematikave do të përcaktohen me marrëveshje, sipas pozicioneve të punës.

Për çdo ndryshim të punonjësve të ngarkuar me detyrat e mësipërme, për të dyja palët, njoftimi kryhet me shkresë zyrtare nga ndjekësit e kontratës, brenda 3 (tre) ditë pune nga koha kur është kryer ndryshimi.

## 8.2 Përgjigja dhe shkallëzimi I shërbimit.

Në tabelën e mëposhtme përcaktohet kategorizimi i seriozitetit të problemeve dhe koha e kërkuar e përgjigjes për zgjidhjen e tyre.

Kategoria A ( Kritik/ i Lartë)	Kategoria B (i Mesëm)	Kategoria C (i Ulët)
<b>Mos funksionimi i sistemit krijon apo rrezikon shumë aktivitetin normal</b>	<b>Mos funksionimi i sistemit krijon vonesa në aktivitetin normal</b>	<b>Mos funksionimi i sistemit pengon në mënyrë minimale aktivitetin</b>
Numri i përdoruesve të ndikuar		
Mos funksionimi i sistemit ndikon një numër shumë të madh të përdoruesve	Mos funksionimi i sistemit ndikon një numër të vogël të përdoruesve	Mos funksionimi i sistemit ndikon pjesërisht në disa përdorues
Pezullimi i punës		
Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit të realizojnë pjesën më të madhe të punës së tyre.	Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit të realizojnë pjesë të punës së tyre	Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit të realizojnë disa pjesë të vogla të punës së tyre

Zgjidhje alternative e përkohshme		
Nuk ka një mënyre alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit	Ka pjesërisht një mënyre alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.	Ka një mënyrë alternative të përkohshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.
Koha e përgjigjes		
<input type="radio"/> 15 min. për të kthyer përgjigje <input type="radio"/> Në vend brenda 60 min.	<input type="radio"/> 60 min. për të kthyer përgjigje <input type="radio"/> Në vend brenda 2 orëve	<input type="radio"/> 120 min. për të kthyer përgjigje <input type="radio"/> Në vend brenda 48 orëve
Koha e zgjidhjes		
Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 2 orë pas kërkesës.	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është brenda 2 ditëve të punës.	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 10 ditë kalendarike.

### ANEKSI 3: PLANI I IMPLEMENTIMIT

#### 9. PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR REALIZIMIN E MIREMBAJTJES

Ofertuesit duhet të paraqesin ofertën e tyre të detajuar për çmimin pa tvsh dhe totalin pa tvsh për shërbimin e kërkuar, për periudhën e kohëgjatjes së shërbimit.

Nr.	Pershkrimi	Sasia	Njesia
1	Mirëmbajtje software CRM dhe Billing	12	Muaj
2	Shërbime Suporti Onsite dhe Remote	12	Muaj
3	Mirëmbajtje Hardware	12	Muaj

#### 10. KËRKESAT TEKNIKE

*Teknologjia e sistemit CRM&Billing është si më poshtë:*

Sistemi CRM&Billing i OSHEE është implementuar në një infrastrukturë e cila ndodhet në datacenterin e OSHEE, në një skenar me Disaster Recovery Site. Aktualisht në të dy siset janë të instaluar edhe të konfiguruar 20 (njëzet) servera (13 në site-n primar, 7 në disaster recovery) si më poshtë:

**Primary Site:**

Type	Fujitsu Primergy	CPU Qty	CPU Name	DIMM Qty	RAID Controller	Physical Disks Qty / RAID Type	OS Version
RX2530M1		2	Intel Xeon CPU E5-2620 v3 2.40G 2 x 16 GB 1866MHz		PRAID CP400i	4 x 300GB SAS 15K / RAID 10	Windows Server 2012R2
RX2530M1		2	Intel Xeon CPU E5-2620 v3 2.40G 2 x 16 GB 1866MHz		PRAID CP400i	4 x 300GB SAS 15K / RAID 10	Windows Server 2012R2
RX2530M1		2	Intel Xeon CPU E5-2620 v3 2.40G 2 x 16 GB 1866MHz		PRAID CP400i	3 x 300GB SAS 15K / RAID 5	RHEL 7.5
RX2530M1		2	Intel Xeon CPU E5-2620 v3 2.40G 2 x 16 GB 1866MHz		PRAID CP400i	3 x 300GB SAS 15K / RAID 5	VMWare ESXi 6.5.0 (Build 5310538)
RX2530M1		2	Intel Xeon CPU E5-2620 v3 2.40G 2 x 16 GB 1866MHz		PRAID CP400i	3 x 300GB SAS 15K / RAID 5	VMWare ESXi 6.5.0 (Build 5310538)
RX2530M1		2	Intel Xeon CPU E5-2680 v3 2.50G 6 x 16 GB 2133MHz (192GB)		PRAID CP400i	3 x 300GB SAS 15K / RAID 5	RHEL 7.3
RX2530M1		2	Intel Xeon CPU E5-2680 v3 2.50G 6 x 16 GB 2133MHz		PRAID CP400i	3 x 300GB SAS 15K / RAID 5	RHEL 7.3
RX2530M1		2	Intel Xeon CPU E5-2620 v3 2.40G 2 x 16 GB 2133MHz		PRAID CP400i	3 x 300GB SAS 15K / RAID 5	RHEL 7.5
RX2530M1		1	Intel Xeon CPU E5-2620 v3 2.40G 4 x 16 GB 1866MHz		PRAID CP400i	3 x 300GB SAS 15K / RAID 5 + 1 x 300GB SAS 15K Hot Spare	Windows Server 2012R2
RX2530M1		2	Intel Xeon CPU E5-2620 v3 2.40G 2 x 16 GB 1866MHz		PRAID CP400i	3 x 300GB SAS 15K / RAID 5	RHEL 7.5
RX2530M1		1	Intel Xeon CPU E5-2640 v3 2.60G 2 x 16 GB 1866MHz		PRAID CP400i	3 x 300GB SAS 15K / RAID 5	RHEL 7.5
RX2530M1		2	Intel Xeon CPU E5-2620 v3 2.40G 4 x 16 GB 1866MHz		PRAID CP400i	3 x 300GB SAS 15K / RAID 5	RHEL 7.5
RX1330M2		1	Intel Xeon CPU E3-1270 v5 3.60G 4 x 8 GB 1866MHz		PRAID EP400i	2 x 600GB SAS 15K / RAID 1, 6 x 1TB NL-SAS 7.2K / RAID 5	Windows Server 2012R2

**DC:**

5 (pesë) serverat e aplikacionit me RedHat Enterprise Linux 7.3, 1 (një) server i databazës dhe 1 (një) backup server me Windows Server 2012 R2.

**Storage:**

Fujitsu Eternus DX200, rreth 20 TB

**Teknologjia software e përdorur për serverat dhe infrastrukturën :**

Infrastruktura e sistemit është Cluster, virtualizuar në Hypervisorin VMWARE ESXi 6.5. VCenter është ndërtuar mbi teknologjinë VCSA (VCenter Server Appliance).

**Sistemet e operimit:**

**1. Windows Server 2012 R2**

Windows Server 2012 R2 është përdorur për krijimin e Cluster-it në të cilin operojnë SQL server Role i databazës së sistemit dhe menaxhimit të dokumentave, gjithashtu edhe i databazës ku kryhen testimet.

**2. RedHat Enterprise Linux 7.3 , RedHat Enterprise Linux 7.5**

Në RedHat Enterprise Linux është instaluar dhe konfiguruar aplikacioni i OpenKM DMS, WebServer-at apache ver. 2.4, aplikacioni Billing i bazuar ne Java vers. 1.6

**Software i databazës:**

1. Microsoft SQL Server 2016

**Software i aplikacionit:**

1. Webserver Apache 2.4, Java vers. 1.6

**Vendi i kryerjes së shërbimit: OSHEE**

---

## Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pushyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

#### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

---

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

---

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **117,982,224 (njëqind e shtatëmbëdhjetë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e dy mijë e dyqind e njëzet e katër)** leke pa TVSH.

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse (*Administrata tatimore*) dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar (*vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar*), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

#### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme (të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme), të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 35 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

---

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i certifikuar sipas standarteve ndërkombëtare (ISO), për të siguruar kontrollin e cilësisë dhe sigurinë mbi informacionin. Për këtë arsye, operatori ekonomik ofertues duhet të zotërojë Çertifikatat e mëposhtme të vlefshme në datën e hapjes së tenderit:

a) **ISO 9001:2015 ose ekuivalente, të sistemit të menaxhimit të cilësisë (e vlefshme).**

b) **ISO 27001:2013 ose ekuivalente, për Sigurinë e Informacionit (e vlefshme).**

c) **ISO/IEC 20000-1:2018 ose ekuivalente, për menaxhimin e shërbimeve të teknologjisë së informacionit (e vlefshme).**

*Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.*

*Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas akt-marrëveshjes paraprake.*

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi /distributori i autorizuar ose certifikatën e të drejtave të autorit për shitjen e produkteve software dhe ofrimin e shërbimeve të përfshira në këtë objekt prokurorimi në territorin e Shqipërisë. Në rast të paraqitjes së autorizimit të prodhuesit/distributorit të autorizuar, autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit të autorizuar si: telefon, fax, e-mail, website, kjo është e nevojshme për Autoritein Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Në rast të paraqitjes së Autorizimit të distributorit, duhet të paraqitet edhe dokumentacioni që verteton lidhjen me prodhuesin. Autorizimi të këtë edhe datën e lëshimit përpara datës së zhvillimit të tenderit.

2.3.4 Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontratës, për planifikimin dhe menaxhimin me profesionalizëm të punës, **duhet të ketë të punësuar jo më pak se 7 punonjës të fushës së teknologjisë së informacionit (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkenca kompjuterike etj).** Gjithashtu, mbështetur në kërkesat e specifikimeve teknike dhe teknologjinë hardware dhe software të sistemit, operatori ekonomik duhet të dëshmojë që ka në stafin e nevojshëm IT, punonjës të kualifikuar me një nga kualifikimet e mëposhtme, minimalisht:

**I- Operatori ekonomik duhet të ketë personel të certifikuar që do të angazhohen në implementimin e projektit:**

a. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për Menaxhim Projektësh ose ekuivalent me 1 (një) vit eksperience në menaxhim projektësh me teknologji CRM/Billing.



- 
- b. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar ITIL ose ekuivalent për shërbimet IT.
  - c. Te paktën 2 (dy) Software inxhinier të certifikuar për zhvillim të aplikacioneve të cilat kanë minimum 3 vite përvojë në zhvillim Oracle Java të softuerit CRM/Billing ose ekuivalent.
  - d. Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për administrimin e serverave në RHEL Linux ose ekuivalent.
